

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendeve vakante **Specialist** pranë FTL / Drejtoria e Planifikimit dhe Nominimit / Sektori i Planifikimit.

SPECIALIST

Sektori i Planifikimit monitoron dhe përgjigjet tek Drejtoria e Drejtorisë së Planifikimit dhe Nominimit për trajtimin e çështjeve që lidhen me operimin e veprimtarisë së planifikimit në terma afat gjatë, afat mesëm dhe afat shkurtër duke analizuar dhe përmirësuar vazhdimisht procesin me qëllim të minimizimit të kostos totale të balancimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat në lidhje me ngarkesën, shitjet, humbjet e energjisë dhe faktorëve të ndryshëm që ndikojnë (faktorëve ekonomik dhe demografik, motit dhe faktorët klimatik, sjelljen e tregut të energjisë, profilin e konsumit dhe sjelljes së konsumatorëve).
- Parashikon konsumin/prodhimin e energjisë në terma afat- gjatë afat- mesëm dhe afat-shkurtër bazuar në të dhënat në dispozicion në korniza të ndryshme kohore (vjetor, tremujore, mujore, ditore, javore, orare), dhe variablat që ndikojnë në konsumin dhe prodhimin e energjisë
- Mbledh të dhënat në lidhje me: ngarkesën, prodhimin e prodhuesve me përparësi, faktorët meteorologjik (temperaturat/reshjet/shi/re/diell)
- Siguron mbledhjen e informacionit të nevojshëm për zbatimin e modeleve të parashikimit të energjisë elektrike.
- Shqyrtimin dhe përditësimin e parashikimit në afatet kohore të përshtatshme sipas rregullave të tregut në fuqi.
- Siguron shkëmbimin e të dhënave për konsumin/prodhimin e energjisë së parashikuar.
- Monitoron zhvillimin aktual të blerjes / shitjes në tregun e energjisë.
- Parashikon blerjen/shitjen/humbjet e energjisë në vite/muaj duke analizuar dhe vlerësuar faktoret ndikues si dhe të detajuar sipas zerave të bilanit energjitik.
- Paraqet programin e energjisë tek palët përkatëse në kohën e duhur.
- Vlerëson dhe kontrollon devijimet / disbalancat referuar të dhënave nga OST për grupin e balancimit dhe palët përgjegjëse të grupit të balancimit.

- Garanton respektimin e afateve kohore të rregullave të tregut në lidhje me nominimet e programeve në day –ahead dhe intra-day për palët përgjegjëse balancuese pjesëtarëve të grupit të balancimit.
- Përgatit raporte të detajuara sipas kërkesave të eproreve.
- Menaxhon dokumentacionin lidhur me parashikimin/planifikimin e konsumit të energjisë dhe bën reflektimin e tij në parashikim.
- Bashkëpunon, me ekipin e departamentit dhe me stafin e departamenteve të tjera.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë përfunduar Fakultetin për Matematikë/ Ing Matematikë/Inxhinieri Elektrike, të ketë diplomë të nivelit “Master Shkencor” dhe të ketë kualifikime/specializime/trajnime të ndryshme;
- Të ketë një përvojë pune mbi 3-vjet, preferohet në fushën e energjisë;
- Njohje dhe aftësi në përpunimin e serive numerike kohore.
- Të jetë i/e aftë të përpilojë, analizojë dhe përgatisë raporte dhe të dhëna specifike që lidhen me fushën e veprimtarisë.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të aftë të punojnë në grup.
- Aftësi të mira (MS Office) etj.
- Të njohë gjuhë të huaja, preferohet gjuha angleze.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.